

Prof. Dr. Ekrem Sarıkçıoğlu

Historia e feve

(prej fillimit deri sot)

Nga turqishtja:

Dr. Qani Nesimi

Titulli origjinal:

Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi

Botoi: Logos-A, Shkup – 2007

DISA FJALË PËR AUTORIN

Ekrem Sarıkçıoğlu ka lindur më 1943, në İsparta të Turqisë. Pas përfundimit të gjimnazit në vendlindje, është regjistruar dhe ka diplomuar në Fakultetin Teologjik në Universitetin e Ankarasë më 1966. Doktoraturën e ka kryer në Fakultetin e Letërsisë në Universitetin Nürnberg-Erlangen të Gjermanisë më 1971, në fushën e Historisë së Feve si bursist i Ministrisë së Arsimit të Turqisë. Në vitin 1977 ka fituar titullin docent në Fakultetin Teologjik të Universitetit “Atatürk”, ndërsa titullin profesor e ka marrë në vitin 1983 në Fakultetin Teologjik të Universitetit “19 Mayıs”. Në vitet 1985-1994 ka qenë dekan i Fakultetit Teologjik të këtij Universiteti. Profesor Sarıkçıoğlu prej vitit 1998 është pedagog në Fakultetin Teologjik të Universitetit “Süleyman Demirel” në İsparta të Turqisë.